

Nga teoria në praktikë: Përvoja dhe ekspertiza e AIC në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të agrobizneseve shqiptare



Trajnimi në terren është një komponent i rëndësishëm i rritjes së aftësisë profesionale dhe kompetencës së fermerëve. AIC ka arritur të realizojë këtë vit projektin për forcimin e fermerëve shqiptarë pavarësisht pandemisë, duke kombinuar përdorimin e mjeteve digjitale me vizitat e trajnimit në terren. Të gjitha mjetet e komunikimit u gjykuan shumë të dobishme nga fermerët shqiptarë të përfshirë në këtë projekt. Demonstrimi në terren solli vlerë të shtuar nëpërmjet një komunikimi të drejtpërdrejtë midis ekspertëve dhe fermerëve dhe pranisë së stafëve të tyre të punës në terren.

Eksperti Italian i praktikave bujqësore Lorian (Loris) Dalle Nogare, agronom, lektor dhe konsulent specialist për kompanitë në Veneto të Italisë, zhvilloi dy vizita trajnuese në Shqipëri.

Frutikultura dhe Multi-funksionaliteti.

Në 22 shtator 2021, Lorian Dalle Nogare vizitoi kompaninë e “Vëllezërve Bullari”, në Cërrik të Elbasanit, një histori inkurajuese suksesi në agrobiznesin shqiptar. Iniciativa origjinale familjare dhe përkushtimi 8 vjeçar i kish ndryshuar pamjen hapësirave fushore, kodrinore dhe malore, të pasura me rezerva ujore, duke i veshur me plantacione të shumëllojshme fruti-kulture si shegë, kivi, arra, bajame, fiq, kumbulla etj. krahas fermës së mjaltit dhe mbarështimit të deleve, dhive dhe shpendëve. Një kompani multifunksionale në të gjitha aspektet e udhëhequr nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe ruajtjes së ekuilibrit biologjik nëpërmjet përdorimit dhe riciklimit të mbetjeve organike.



Përballja e Loris Dalle Nogare me Lulzim Bullarin ishte surprizues, intensiv, me aspekte të panumërta teknike, ide dhe sugjerime për trajtime dhe sisteme që mund të zbatohen me efikasitet në të ardhmen, prezantimin e teknologjive të reja, kultura të tjera të përshtatshme për karakteristikat dhe specifikat e territorit, klimën dhe çështje të zhvillimit social.

Theksi u vendos mbi rëndësinë e përdorimit dhe riciklimit të produkteve natyrore, metodat dhe mjetet gjatë korrjeve për ruajtjen e rendimentit dhe cilësisë, trajtimet organike në vend të atyre kimike.

Një shembull konkret është përpunimi në lagështirë i kombinimit të mbetjeve të gjelbra dhe shtazore për përfitimin e plehut organik me veti të larta ushqyese në fruti-kulturë duke mënjeluar çdo rrezik ndotje të rezervave ujore liqenore të pranishme në territor që zakonisht ndodh kur përdoren plehra kimikë të cilët me kalimin e kohës depozitohen dhe qarkullojnë në rrugë nëntokësore.

Nga ana e tij, Lulzim Bullari theksoi se filozofia e biznesit të tyre familjar ishte orientimi ndaj kujdesit mjedisor dhe një qasjeje të vazhdueshme ndaj metodave natyrore të kultivimit. Njëkohësisht, ai e njohu ekspertin Italian me hapin tjetër të zhvillimit duke ju referuar agroturizmit - tashmë në ndërtim - ku synon t'i ofrojë vizitorëve nga zonat urbane, një oazë qetësie dhe çlodhjeje pranë natyrës, larg betonit, trafikut dhe ndotjes.

Për Ekspertin Dalle Nogare, agrobiznesi i Vëllezërve Bullari mund të quhet një fermë shumë solide, e organizuar, e vendosur mirë se cilës mund ti referohesh si shembull i çmuar për përvojën dhe praktikën e shkëlqyera në agrobiznes. Në terma më të përgjithshëm mund të themi se sot në Shqipëri, *shkëmbimi i përvojave midis fermerëve të rinj (atyre që i kthehen tokës së braktisur familjare, atyre që vendosin të nisin një fermë nga e para, ose që marrin përsipër frenat e një agrobiznesi për ta rinovuar), me ekspertë që kanë një përvojë të tillë të gjatë dhe njohuri të mira të teknologjive të reja është mjaft i çmuar dhe duhet stimuluar. Kjo do të sigurojë zhvillim të territoreve, rritje të punësimit, nxitje të zhvillimit të infrastrukturës publike dhe mbrojtje të territoreve nga degradimi.*



Rrogozhinë, 23 shtator 2021

Koha e fermës.....



Kompania “Koha e fermës”, e themeluar nga tridhjetëvjeçari Ermir Hylviu në Okshtun të Rrogozhinës, i cili ka mbjellë një sipërfaqe prej 23 ha shëgë të varietetit Italian Jolly Red, që sherben si lëndë e parë për industrinë ushqimore të lëngjeve të frutave. Terreni ku janë mbjellë fidanët, dikur tarraca të mbjella me fiq, ka qenë i braktisur për më shumë se 30 vjet. Iniciativa e Ermir Hylviut, duke marrë me qira nga shteti këtë sipërfaqe është mjaft pozitive në ripërtëritjen e tokës bujqësore dhe ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen dhe menaxhimin e terrenit.

Eksperti Italian i fruti-kulturës Lorian (Loris) Dalle Nogare ndau me E. Hylviun njohuritë dhe përvojën e zhvilluar gjatë viteve të punës se tij me frutikulturat venecianë në të gjitha fazat e kultivimit të shëgës. Ndër pikat kryesore në të cilat u fokusua shkëmbimi përmendim rëndësinë e analizës së tokës përpara se të fillohet me mbjelljen e çdo lloji kulture dhe rëndësinë e klimës dhe ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimatike të viteve të fundit.

Duke ju referuar dëmeve që kanë pësuar fermerët italianë nga dukuritë klimatike, Loris Dalle Nogare pyeti hollësisht mbi dukuritë klimatike të stinës së dimrit, të ftohtin, erërat, ngricat e papritura, dukuritë ekstreme gjatë pranverës dhe sugjeroi metoda specifike të kujdesit dhe mbrojtjes për kulturat që rriten në terraca, veçanërisht në terrenet më të larta, ku rrjedhimisht i nënshtrohen presionit të drejtpërdrejt të erës. Pas vizitës në zonën ku mbjellja ishte në proces, Loris dalle Nogare u shpreh i gatshëm të vijojë komunikimin telefonik me fermerin e ri shqiptar, pasi të jetë siguruar furnizimi me fidanët, me qëllim që procesi i mbjelljes dhe kujdesi ndaj trupit të shëgës të bëhet me metodat e duhura n.m.që ato të rriten të sigurta.

